

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarve A.L., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 të KPK dhe B.M., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par.6 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit A.L., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, P.nr.232/2014 datë 12.9.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1163/2017 datë 15.1.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A.L., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, P.nr.232/2014 datë 12.9.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1163/2017 datë 15.1.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë, P.nr.232/2014 datë 12.9.2017, i dënuari A.L., është shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPK dhe për këtë vepër është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga 30.8.2013 gjer më 28.9.2013. Është detyruar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit në shumë prej 572.64 € dhe atë mjeko-ligjore në shumë prej 50 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 100 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Palët e dëmtuara, për realizimin e kërkesave pasurore-juridike janë udhëzuar në kontest civil. Me të njëjtin aktgjykim ndaj të pandehurit B.M., në

pajtim me nenin 363 par.1 pika 1.1 të KPK, është refuzuar akuza për shkak se Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza. Është vendosur që në këtë pjesë shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1163/2017 datë 15.1.2018, është refuzuar ankesa e mbrojtësit të të dënuarit A.L., kurse aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, mbrojtësi i të dënuarit A.L., T.B., avokat nga Gj., ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të ndryshohen përkitazi me vendimin për dënimin duke mos dhënë një propozim konkret.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.70/2018 datë 16.4.2018, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimet kundërshtohen për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, nga referati i kërkesës del se këto pretendimet ndërlidhen me vendimin për dënimin. Kështu, theksohet se arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë, është i pakuptueshëm meqë mungojnë arsyet lidhur me lartësinë e dënimit kështu që arsyet e dhëna janë në kundërshtim me dënimin e shqiptuar. Më pas, theksohet se në arsyetimin e aktgjykimit gjykata ka konstatuar se nuk ka gjetur rrethana rënduese kurse drejt ka vlerësuar rrethanat lehtësuese, për të theksuar se dënimi i shqiptuar ndaj të dënuarit është shumë i rëndë dhe jo proporcional me rrethanat e rastit. Gjykata e shkallës së dytë e ka konfirmuar vlerësimin e rrethanave lehtësuese nga gjykata e shkallës së parë, mirëpo, as kjo gjykatë nuk e ka pa të arsyeshme që të ndryshojë vendimin mbi dënimin në favor të dënuarit.

Gjykata Supreme, konstaton se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e dënimit i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat qëndrojnë në anën e të dënuarit të cilat i ka konfirmuar edhe gjykata e shkallës së dytë. Vlen të theksohet se matja e dënimit është e drejt diskrecionale e gjykatës kështu që gjykata në rastin konkret të njëjtat i ka vlerësuar në përputhje me dispozitën e nenit 73 të KPK, duke i shqiptuar dënimin brenda kufijve të paraparë për këtë vepër penale, për

çfarë të dy gjykatat, e shkallës së parë në faqen 5, ndërkaq ajo e shkallës së dytë në faqen 3 të aktgjykimit, kanë dhënë arsye të qarta të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Përkitazi me shkeljen e ligjit penal Gjykata Supreme, konstatoj se konform dispozitës së nënti 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënimin shkeljet e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm, për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore. Në rastin konkret dënimi i shqiptuar është brenda kufijve ligjore të paraparë për këtë vepër penale.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 347 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
PML.nr.95/2018, më 14 maj 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta